



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË VLORË

Nr.6857/1prot.

Vlorë, më 03.08.2018

**VENDIM**

Nr. 91 Datë, 03.08.2018

**PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË SUBJEKTEVE TË CILËT KANË  
PARAQITUR OFERTA NË PROCEDURËN PËR ZGJEDHJEN E PËRFAQSUESIT  
LIGJOR TË BASHKISË VLORË NË DHOMËN NDËRKOMBËTARE TË  
TREGËTISË PARIS LIDHUR ME PADINË E SHOQËRISË “TIS PARK”SH.P.K SI  
DHE PËRCAKTIMIN E SUBJEKTIT FITUES**

Në zbatim të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 7 pika c, ligjit nr.135/2015 “Për vetqeverisjen vendore“ neni 8 pika 2, neni 9/1 pika 1/1,a,b,c dhe d, neni 54 pika dh, h dhe k, ligjit nr.55/2015 dt.30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative“ neni 3 pika 3, dhe neni 11, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.73 dt.17.07.2018, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë nr.90 dt.31.07.2018, si dhe shkresës nr.1606/5 prot dt.02.08.2018 të Avokaturës të Përgjithshme të Shtetit, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 03.08.2018

**VENDOSI:**

1. Renditja e subjekteve bazuar në vlersimin e plotësimit të kriterëve të përcaktuara në V.K.B nr.73 datë 17.07.2018 të jetë si më poshtë:

1. STUDIO BAKER McKENZIE	me 96 pikë
2. GRIMALDI STUDIO LEGALE	me 94.7 pikë
3. STUDIO CLIFFORD CHANCE	me 93.4 pikë
4. STUDIO LEGALE CONTE	me 12,2 pikë
5. STUDIO LEGALE LIPAROTA	me 11.7 pikë
6. STUDIO DAVIDE PEROTA	me 11.4 pikë

2. Të shpallet fitues STUDIO BAKER McKENZIE për të përfaqësuar Bashkinë Vlorë në Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë Paris për gjykimin e padisë të ngritur nga shoqëria koncesionare Tis Park shpk.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Monitorimit të Procedurës për nisjen e negociatave për kushtet e kontratës me studion ligjore fituese.
4. Drafti i kontratës i negociuar nga palët sipas pikës 2 të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë së bashku me fondin e vlerës së kontratës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ neni 55 pika 6.

**KRYETAR**

**Vojsava SHKURTAJ**